


I:

Paraqitja skematike e organogjenezës së degzës njëvjeçare frytdhëse dhe tri alternativat e mundëshme të zhvillimit të sajë gjatë periudhës trivjeçare




II:




Paraqitja skematike e organogjenezës së degzës dyvjeçare frytdhëse dhe tri alternativat e mundëshme të zhvillimit të sajë gjatë periudhës katërvjeçare

Disa parime bazë të rritjes së degëzave






Dy degë të cilat kanë të njëjten pikë të daljes dhe në të njëjtin kënd në raport me udhëheqësin qendrorë kanë rritje të njëjtë

Dy degë të cilat kanë të njëjten pikë të daljes ajo që ka kënd më të ngushtë ka zhvillim më të fuqishëm në raport me degën me kënd më të hapur



Dy degë të njëjta cilat kanë pika të ndryshme të daljes në udhëheqësin qendrorë ajo që është më lartë ka bujshmëri më të lartë


Dy degë të cilat kanë të njëjten pikë të daljes dhe në të njëjtin kënd në raport me udhëheqësin qendrorë bujshmëri më të larë ka ajo që ka diametër më të madh në bazë



Dy degë të cilat kanë të njëjzat karakteristika më shumë do të zhvillohet ajo që ka më tepër degëzime


Degëzat mbi degë me pozitë vertikale të cilat janë më afër udhëheqësit qendror do të kenë zhvillim më të bujshëm

Degët që kanë këndë më të hapur janë më pakë të bujshme dhe diferencojnë sytha frutor më lehtë se ato që kanë kënd më të ngushtë




Mbi degëzat njëvjeqare rritja më e fuqishme do të ndodhë në pjesën e sipërme të degzës


Sa më i madh të jetë lakimi më tepër do të paraqiten degzime frutore në pjesën e poshtme të degzës një vjeqare



Mbi degzën njëvjeqare me pozitë horizontale do të rritet numri i sythave të zgjuar dhe do të paraqiten degëza të dobëta me tendencë të krijimit të sythave frutor



Mbi degëzat njëvjeqare të lakuara në formë harku do të shfaqet rritja e një deri dy lastarëve më të fuqishëm (shaluesve) në zonën e sipërme të harkut ndërsa sythat tjerë do të japin rritje të dobët me tendencë kah frutdhënja



Lakimi I degëzave njëvjeqare në kënd 120 deri 180 shkallë më së shumti do të japin një deri dy rritje të fuqishme afër bazës së degës ndërsa sythat e tjerë në drejtim të majës do të japin rritje të dobët me tendencë kah frutdhënja

Njohja cikleve të zhvillimit

- **Cikli jetësor** – *Faza embrionale* (nga fekondimi i lules deri te mbirja e farës), *Faza e rinisë* (vegjetative), *Faza pjekurisë* (frutdhënës), *Faza plakjes*
- **Cikli Vjetorë** – *Faza e vegjetacionit* dhe *Faza e qetësisë së detyrueshme*


Format e kurorave

- **Formë e lire**
- **Gjysmë e dirigjuar** – piramidë e përmirësuar, vaze e përmirësuar
- **Dirigjuar** – Piramidale, vazë, palmetë, kaçubë e thepisur, shtizë e hedhur, aksi vertikal, balerinë, hajtek, V sistem, shtizë e dyfishtë etj

Karakteristikat e kultivarëve

- **Reneta kanadeze** – degëzat në këndin 10 – 70 shkallë formojnë sytha frutor
- **Starkrimsoni** – degëzat në këndin 00 – 80 shkallë formojnë sytha frutor
- **Delisheci të artë** – degëzat në këndin 30 – 120 shkallë formojnë sytha frutor
- **Gala** – degëzat në këndin 45 – 100 shkallë formojnë sytha frutor
- **Greny Smithi** – degëzat në këndin 70 – 180 shkallë formojnë sytha frutor

Paraqitja skematike e zonës së balancuar në mes zhvillimit (rritjes) dhe prodhimit





A



B

I - Tipi bazotonik i zhvillimit dhe frutdhënjes te molla





A




B

II - Tipi mezotonik i zhvillimit dhe frutdhënjes te molla





A



B


III - Tipi mezotonik me kënd të hapur të degëzimeve i zhvillimit dhe frutdhënjes të molla




A



IV - Tipi akrotonik i zhvillimit dhe frutdhënjes te molla



B



Klasifikimi i pemëve sipas sipas rritjes dhe formimit të degëzave të molla, lespinasse (1977)

Njohja e kohës së krasitjes

- **Krasitja në fazën e qetësisë (krasitja themelore, dimërore, apo në pjekuri)**
- **Krasitja në fazën e vegjetacionit (krasitja verore, plotësuese apo e gjelbër)**

Parimet e krasitjes dimërore

- **Veglat - adekuate dhe të pastërtia (të dezinfektuar kohë pas kohe me alkool 90%)**
- **Krijimi i vizionit – sistemi i kultivimit, forma, konkurrenca, ndriçimi, ngarkesa me lule**
- **Largimi i pjesëve të sëmura , të infektuara dhe të thyera**
- **Degëzat njëvjeçare largohen tërësisht nga kurora e pemës, të priten në qep ose ngelin të pa prekura**
- **Degëzat e vjetra veshëze ose ato dy vjeçare rrallohen ose priten**
- **Degët skeletore mirëmbahen në atë lartësi që do ti përgjigjet sistemit të projektuar të kurorës duke larguar lastarët e fuqishëm nga majat e këtyre degëve, (konkurrentët ose fshesat)**
- **Degëzat dhe degët konkurrenente ndaj udhëheqësit qendror shkurtohen në çep**
- **Unazimi i pjesëve të zhveshura të udhëheqësit qendror mbi syth të fjetur apo degëze të zhvilluar dobët (Mars – Maj)**
- **Largimi i pjesëve të prera nga pemishtja**





E RREGULLT



JO E RREGULLT






Prerja e udheheqesit



IZOLIMI I UDHEHEQESIT













Degeza per ripertritje





22/02/2005











Krasitja e gjelbër

Krasitja e gjelbert – masat teknike

- Qellimi
- Koha e krasitjes
- Teknikat e krasitjes se gjelbert - masave

Qellimi

Aplikohet me qëllim të rregullimit të ekuilibrit në mes të pjesës vegetative dhe frutdhënëse të pemës, plotësimit të krasitjes dimërore, efektet e së cilës janë:

- Rritja e ndriqimit dhe ajrosjes së kurores
- Përmirësimi i kualitetit të frutave që nënkupton: ngjyren, madhësinë e frutit, përmbajtjen e materieve ushqyese në frut
- Eliminimin e konkurrenteve dhe shfrytëzimin racional të ujit dhe materieve ushqyese
- Nxitja e krijimit të sythave frytorë dhe degëve prodhuese për vitin e ardhshëm
- Largimi i degëve të lënduara ose të infektuara nga sëmundjet deri në vendin e shendosh
- Krasitja e gjelbër zvogëlon bujshmerinë në krahasim me krasitjen dimërore e cila rrit bujshmerinë e pemës
- Pemet me bujshmeri të ulët nuk duhet krasitur gjatë verës

Koha e krasitjes se gjelber

- Periudha Pranverore (gjysma e Majit fundi i Qershorit)
 - Njihet si periudhe baze e krasitjes se gjelber dhe masave tjera pomoteknike per te siguruar nje balanc ne kurorën e pemës
- Periudha verore (Korrik - Shtator)
 - Ka per qellim plotesimin e krasitjes paraprake pranverore dhe me teper eshte e aplikueshme kur pemët janë ne formim te kurorës
- Periudha vjeshtore
 - ne kete kohe krasitja aplikohet shume me pak vetem ne raste te veçanta (prezenca e ndonje sëmundje qe kerkon edhe menjanime mekanike)



Teknikat e krasitjes së gjelbër – masat

- Lakimi
- Largimi i pjesëve të caktuara të pa nevojshme nga pema
- Rrallimi i frutave

Lakimi

Lakimi është një masë shumë me rëndësi në formimin e kurores së pemëve dhe aplikohet që nga viti i parë deri të formimi i kurores viti i katërt. Kjo masë zbatohet në gjysmën e dytë të Prillit dhe varesisht nga teknika dhe zhvillimi i degzave mund të aplikohet deri në Korrik apo edhe Gusht

- ▶ Lakimi përmes peshave të ndryshme nga betoni rera etj. (aplikohet të llastaret e drunjezuar vendosen në pika të ndryshme të llastarve ku sigurohet lakim optimal 70-90 shkale)
- ▶ Lakimi përmes rremojcave të dhembve (aplikohet kur baza e llastarit fillon të drunjezohet dhe arrijnë gjatësinë 15- 25 cm)
- ▶ Lakimi përmes litarit – spagos (aplikohet të llastar të drunjezuar përdoren spago ambientale nga materiali bimor të cilat pas një kohe zberthehen, është një formë mjaft e aplikueshme dhe funksionale në prodhimtarinë intensive)
- ▶ Lakimi përmes pajisjeve speciale plastike
- ▶ Lakimi përmes përdredhjes (aplikohet kur ka rritje shumë të fuqishme të llastarve (fundi I Majit gjysma e Qershorit)









Largimi i pjesëve të caktuara të pa nevojshme nga pema


- Rrallimi (harrja) e filizave (lastarë të pa drunjëzuara) që nuk kanë pozicion të mirë në pemë
- Largimi i lastarve në fazën e hershme në gjatësi 25 - 30 cm (në forme të ththakeve, me kënd të ashprë)
 - Mund të hiqen me thyerje nga baza
 - Dhe me shkurtim në gjatësi prej 1cm nga baza përmbi dy gjethet e poshtme të dobëta
- Izolimi i udheheqesit qendror (largimi i 2-3 filizave nën vazhduesin e udheheqesit qendror)
- Deget e prera në krasitjen dimerore prodhojnë 2-3 lastar prej të cilëve duhet menjëherë meatarisht dy
- Pincerimi dhe shkurtimi i lastarëve të caktuar me qëllim të kufizimit të rritjes, favorizimit apo nxitjes së krijimit të lastarëve të tjerë anësor me perspektive frutdhëse
- Largimi i pjesëve të infektuara



Fig .17. Harrja e filizave



Fig .18. Shkurtimi i lastarëve













Fig .19. Pincirimi








Rrallimi i frutave

- Pemët kanë kapacitet që të formojë fruta me shume se sa janë të nevojshem
- Rrallimi i frutave në shumicën e rasteve është i nevojshem
- Shumica e sythave frutor inicohen 4-6 jave pas lulezimit
- Rrallimi i vonshem nuk ndihmon në inicimin e sythave frutor dhe shpesh ndodh frytëdhënia alternative
- Mesatarisht është e mjaftueshme e të lehen frutat në distance 15cm përgjatë degës ndërsa një lulëri mjafton ta ketë 1 frutë maksimalisht 2 fruta
- Mënyra e rrallimit të frutave :
 - Me dorë
 - Në mënyrë të mekanizuar
 - Rrallimi kimik







F37⁶

F32⁵

F27⁵

F23⁴

F19³

F15³

F12²

F9²

F7¹

F5¹

F3¹

.





Përdorimi i preparateve kimike për rrallimin e frutave tek molla

Preparati	Koha e aplikimit	Doza	
		<u>Cv. vetështerpë</u>	<u>Cv.vetëpllenues</u>
DNOC - 20%	Lulëzim i plotë	63 - 84ml/100 l	125-167ml/100l
NAA	15-25 ditë pas L.plotë	100 ppm	15 - 20ppm
NAAm	15-25 ditë pas L.plotë	30 ppm	50 ppm
SEVIN-50%	30-35 ditë pas L.plotë	75-100ppm	120g/100l
MORESTAN- 25%	20-30 ditë pas L.plotë	60g/100l	90g/100
ETHEPHON	20-30 ditë pas L.plotë	100ppm	200g/100l



Fruti qendror duhet te kene
Dimension 8 -10 mm



Kurorat e pemëve

Sistemet e kultivimit

- Sistem i kultivimit deri ne vitin 1960 eshte nenkopyuar forma e kurores dhe lartesia e trungut
- Forma e kurores eshte njeri prej faktoreve baze te rentabiliteti te frudhenjes se pemeve, ndersa te gjith faktoret tjere jane plotesue si numri i bimeve per/ha, dhe teknologjia e aplikuar.
- Sipas konceptit me te ri me sitem te kultivimit nenkuptohet :

numri i bimeve + forma e kurores + teknologjia e aplikuar + mekanizimi.

- Sipas numrit te bimeve per ha.sistemet mund te klasifikohen ne keto grupe:
 - *dendesi e rrelle... deri 500 trupa/ha*
 - *dendesi e mesme...500-1000 t/ha*
 - *dendesi e dendur...1000-3000 t/ha*
 - *dendesi shume e dendur mbi 3000 t/ha.*

FORMAT E KURORES		distanca e mbjelljes (m)	fidan/ha	rendimenti kg/trung	rendim tona/ha
A	FORME E LIRE	10 X 10	100	200	20
B	FORME KLASIKE	7,5 X 4,5	300	100	30
C	FORMA INTESIVE	4,0 X 2,5	1000	40	40
D	INTENSIVE E LARTE	3,7 X 0,9	3000	20	60
E	SUPER INTENSIVNE	2,0 X 0,5	10000	8	80

Format e kurorave

- Shumica e pemëve frutore dhe bimeve drunore mund të trajnohen për të krijuar pothuajse çdo formë arkitekturës së kurorës,
- Disa forma të njohura janë zhvilluar për t'iu përshtatur nevojave të ndryshme si dhe tipareve individuale (karakteristikave gjenetike) të pemëve.
- Disa format mund të krijohen pa sistem mbështetës, ndërsa disa kanë nevojë për sistem mbështetës.
- Gjatë përzgjedhjes një forme të arkitekturës së pemëve, duhet marrë në konsideratë tre faktorë kryesorë:
 - Tiparet e rritjes: nëse doni të kultivoni një pemë molle me formë shpalir (muri), duhet përzgjedhë kultivarë me lastarë e shkurtër (spurs) dhe nënshartesa me bujshmëri të dobët ose kombinim mes tyre.
 - Hapësirën në dispozicion dhe numrin e bimëve të nevojshme për polenizim.
 - Mundësia e përkujdesjes dhe njohuritë përkatëse për zbatimin e formave të ndryshme të kurorave (si kordoni dhe spalir, etj)


Format e kurorave

- **Formë e lire**
- **Gjysmë e dirigjuar** – piramidë e përmirësuar, vaze e përmirësuar
- **Dirigjuar**
 - **Hapsinore**: piramidale, vazë, kaçubë e thepisur, shtizë e hedhur, aksi vertikal, balerinë, solaks hajtek, V sistem, shtizë e dyfishtë etj
 - **Sheshët**: palmetë, Y, gardhi Belg

Format e lira



**Normale
(Standard)**



Shtyllore



Përpyjetë



Ngjeshur



Lotues



Përhapur



Shtylllore



Fshesë



Përpyjetë



Përhapur




Varur



Lotues

Korigjimi dhe ripërtritja
e kurorës së pemëve




*Kurora e mbushur me degëza të
rritura dhe të dendura disa të
thata dhe dëmtuara , ndriqim i
kufizuar dhe ajrosje e dobët*

*Kryqëzim dhe fërkim i degëve
me njëra tjetren*

*Lirimi i hapësirave përgjat
degëve për të mundësuar
veshjen e tyre me gjethë dhe
degëza frutore*


*Hapja (lirimi) i kursorës për
depërtimin e dritës dhe
qarkullimin e ajrit*



*Pastrimi i trungut dhe pjesëve të
poshtme të degëve nga
degëzimet e pa nevojshme*

Korigjimi dhe rregullimi i kurorës së pemëve pas krasitjes së ashpër


Prerja e majave të rritjeve njëvjeçare në pjesën e sipërme të kurorës (1/3) për stimulimin e degëzimit të tyre



Eliminimi i të gjithë thithakëve (rritjeve njëvjeçare me pozitë vertikale) përgjatë degëve


Largimi i plote i degëzave nga trungu, pjesët e poshtme të degëve skeletore

Prerja e majave të degëve kryesore rritjeve njëvjeçare në pjesën e sipërme të kurorës për stimulimin e degëzimit aanësore



Eliminimi i të gjithë thithakëve (rritjeve njëvjeçare me pozitë vertikale) përgjatë degëve për të favorizuar degëzimet me pozitë të mirë


Prerja e degëve të trasha në qendër me qëllim të hapjes së kurorës



*Eliminimi i të gjithë thithakëve
(rritjeve njëvjeçare me pozitë
vertikale) të zhvilluara pas
prerjeve paraprake të degëve
në qender të kurorës*

*Krasitja për të
nxitur formimin
e rritjeve të
shkurta me
potencial
prodhues*

nr.
fidane/ha




Format hapsinore te kurorave


- A . Kurora hapsinore me dege qendrore
- B. Kurore hapsinore pa dege qendrore

1- Kurorat hapsinore me dege qendrore me dimensione te medha dallohet :

- *piramida e zakonshme*
- *piramida me kate*
- *piramida me kate te permirsuara*
- *piramida me tup pa kate*




piramida e zakonshme




piramida me kate

5-7 LETO

ODBERNI TUDI ZADNJE VEDE VRH ODREŽEMO.



ZAPOLNENOST PROSTORA Z VEJAMI OGRODJA KI RODNIM LESOM



SCHEMATIČNI PRIKAZ KROŠMDE VZGOJENE V OBLIKI ZBOLJSANE PIRAMIDE (LEADER CROWN)


KAZALO:

(1) - Primarne-glavne vje - ročni pogoniki

Piramida me kate te permirsuara

Kurore hapësinore pa degë qendrore

- Vaza (kupa)
- Foma kupore klasike
- Kupe e permirsuar



Karakteristikat baze te Vazes



Kurora Vaze eshte kurore baze me dege skeletore

Nuk eshte e pershtatshme per mbjellje te dendur

Distancat e mbjelljes jane te ndryshme dhe mund te sillen 3-4 m ne rend dhe 3,5-4 m ne mes te rendeve.

Tehnika e formimit percaktohet duke shkurtuar fidanin deri ne 80 cm nga e cila gjatesi 60 cm lehet per formimin e trungut.


Ne 20 cm e lena zgjidhen 3-4 dege baze skeletore per formimin e kurores..




NAVADNO OBLIKOVANA KROŠNJA - ZBOLJŠANA, KOTLASTA VETVICA (V 5. LETU)

B. Kurore hapësinore pa degë qendrore


- Vaza (kupa)
- Foma kupore klasike
- Kupe e permirsuar




a)





b)




a)




b)




Foma kupore klasike



Palmeta e rregullt





Viti i parë i formimitë të kurorës palmetë e rregulltë





Formimi i palmetës: A – prerja e fidanit në vitin e parë B- Pamja e pemës në fund të vegetacionit të parë, C – Masat gjatë krasitjes dimërore (prerja e udhëheqësit qëndrorë, dhe lakimi i degëve skeletore të katit të parë)

Viti i dytë





D – Pamja e kurorës në fund të vegjetacionit të dytë, E – Masat në formimin e katit të dytë, mirëmbajtjes së katit të parë dhe inicimi i formimit të katit të tretë

Viti i tretë






F - Pamja e kurorës pas krasitjes para vegjetacionit e tretë, G – Pamja e kurorës në fund të vegjetacionit të tretë

Viti i katërt




H – Masat që ndermerren në fund të vegjetacionit të tretë, G – Pamja e kurorës pas krasitjes para fillimit të vegjetacionit të katër

Mënyra të ndryshme të formimit të krahëve të palmetës




A – Lidhja e krahve për telave , B- Pëdorimi I bambuve ose letvave të drurit, C- Lakimi I krahve përmes spagove duke I lidhur në kundra të vendosura në tokë , D - Pëdorimi horizontal i bambuve ose letvave të drurit,





Kaçuba e thepitur




- Rritja skeletore
- Rritja gj.skeletore




Karakteristikat

- ❖ Degët skeletore janë të vendosura në pozitë horizontale përgjatë udhëheqësit qëndror
- ❖ Ka përparësi në raport me format klasike, më heret hynë në frutdhënje dhe jap rendimente më të larta
- ❖ Dobësitë - në periudhën e frutdhënjes së plotë bie prodhimi në degët e poshtme skeletore
- ❖ Për të tejkalu këtë dobësi mund ta paraqesim formën e kaçubës me tri degë skeletore të cilat janë të pozicionuara në pjesën bazale të kurorës
- ❖ Kjo formë është e bujshme për konceptin e mbjelljeve të dendura

Kaçuba tredegëshe



KAÇUBA E THEPITUR




- Fidani shkurtohet ne lartësinë e caktuar duke zgjedhur 3 deri 5 sytha te shendosh nen vendin e shkurtimeit. (a).
- Nëse është fidani me dege te formuara atëherë mënjanohen te gjitha degët deri ne lartësinë e duhur ndërsa degët tjera prehen ne forme piramidale (b)
- Udhëheqësi qendror shkurtohet në mënyre që të stimulohet zhvillimi I degëve anësore dhe të vazhdoj rritja dhe krijimi I degëzimeve të radhës
- Ne vitin vijues udhëheqësi qendror shkurtohet varësisht prej rritjes 1/3 (c) dhe degëzat e dala duhet te lakohen ne kënd te gjere.
- Kur te arrije lartësin e dëshiruar atëherë lartësia e kurorës shkurtohet duke e zgjedhur një degëz anore horizontale (e).
- Te gjitha degët te dala ne udhëheqësin qendror radhiten ne mënyre spirale.
- Degët frutore duhen te përtërihen vazhdimisht .
- Te pjeshka dhe llojet tjera te pemëve per tri deri ne katër vite krijohet volumi i plote i formës se kurorës.

Fidanët janë te shartuara ne nenshartesa me bujshmeri te mesme MM106, MM111, M 7, M 26,




Shtiza e hedhur

Karakteristikat




- ❖ Sistem I kurorës pa degë skeletore, me përmasa të vogla
- ❖ Degët gjysëmskeletore dhe degëzat janë të vendosura përgjatë udhëheqësit qëndror
- ❖ Për formimin e degëve gjysëmskeletore përdoret çdo rritje vegetative që nuk ka kënd të ashpër, ndërsa renditja e tyre përgjatë udhëheqësit qëndrorë është në formë spiralje në distancë 15 – 25 cm
- ❖ Në gjithë kurorën, duhet larguar vetëm lastarët që kanë kënd të ashpër dhe me lakim nuk mund ta arrijnë këndin 90°
- ❖ Distanca e mbjelljes janë 3.5 – 4 m X 1-1.5m
- ❖ Ky system mund të ketë sukses në kumbinimet e kultivarëve me nënshartesa me bujshmëri të ulët
- ❖ Te nënshartesat me system rrënjorë të cekët (M9) nevojitet mbështetëse e veqanët për bimë përveç sistemit mbështetës deri sa të forcohet sistemi rrënjorë

Shtiza e hedhur




Viti i parë i formimitë të kurorës shtizë e hedhur




Formimi i shtizës së hedhur: A – Kur fidanët janë të degëzuara prerja bëhet 30 – 40 cm mbi degëzimin e sipërm gjerësia 30 cm ndërsa punët tjera janë të ngjashme me vitin e dytë kur fidanët nuk janë të degëzuara. B - Kur fidanët nuk janë të degëzuara shkurtimi bëhet në lartësi 80 cm. Gjatë vegjetacionit është e dëshirueshme të krijohen 3 -4 degë me kënd të përshtatshëm raport me boshtin udhëheqës

Viti i dytë




Formimi i shtizës së hedhur në vitin e dytë. E – Degët e formuara si rezultat i krasitjes dimërore dhe verore nga vegjetacioni paraparak . F- Përshkrimi i krasitjes dimërore pas përfundimit të vegjetacionit të dytë. a) eliminimi i udhëheqsit qendrorë në bazë, b) zëvendësi i udhëheqësit të qendror shkurtohet në 1/3, ro) zona e zhveshur (zbrazët) e udhëheqësit qendrorë si objektive për të fituar degë të reja gjysmë skeletore (përgatitja për formimin e masës drunore fryt dhënëse). Degët gjysmë skeletore të formuara përgjatë vitit të parë dhe të dytë të vegjetacionit nëse janë ndërmarrë masa adekuate pomoteknike përgjatë tyre janë krijuar degëza frutore të cilat gjatë evolucionit të tyre të më vonshëm në vitet e ardhshme duhet të përtërihen (shkurtohen). G – Kurora pas krasitjes dimërore

Viti i tretë





Krasitja dimërore shtiza e hedhur në vitin e tretë (pas vegjetacionit të tretë): H – Kurora e zhvilluar si rezultat i krasitjes dimërore dhe verore nga vegjetacioni paraparak G). I – Përshkrimi i krasitjes dimërore: Δ) shkurtimi i vazhduesit të udhëheqësit qendror, er) efektet e gjysmë unazimit (degë të reja gjysmë skeletore), renditja e degëzave një vjeçare me kënde të përshtatshme; krasitja e degëve gjysmë skeletore të posa formuara në degëza frutore dhe degëzave të reja të dalë nga baza e degës frytdhënëse. J – Kurora e boshtit të hedhur pas krasitjes dimërore

Viti i katërt




Krasitja dimërore te shtiza e hedhur në vitin e katër. Formësimi i kurorës merr pamjen përfundimtare (përgatitjet përfundimtare për mënjanimin e udhëheqësit në vegjetacionin vijues). Krasitja në frutëdhënje bëhet paralelisht me masat pomoteknike të rritjeve për zëvendësim (rritje të reja gjysmë skeletore – përgatitja) bartësi i degëzave frutore mund të pritët afër degën frutore ose përtërihet ose mënjanohet në çep.

Krasitja në prodhim



Krasitja e shtizës së hedhur – mënjanimi i udhëheqësit dhe masat në krasitjen e rregullt: sjellja e degëve gjysmë skeletore në këndin horizontal. Prerja e bartësit të degëzave të reja frutore pranë degëzës veshëse ose të poshtëme frutore, përtëritja e bartësit të degëzave të vjetra frutore prerje ose mënjanim me prerje në çep.

Sistemi mbështetës



Ilustrim grafik i llojeve të përforcimeve A – Shtylla me dy rende tela B – Shtylla me një rend teli

Sistemi balerinë

- Është një prej formave boshtore të kurorave me udhëheqës qendror e cila ka gjetur një aplikim të gjerë në prodhimtarinë intensive të mollëve në vendet e zhvilluara si në Gjermani, Holandë etj.
- Sistemi “balerinë” është formë e kurorave intensive të mollës me dimensione të vogla “vjelje me dorë”: rreth 2.5 – 3 m lartësi, kurora e të cilave është e ndarë në tri zona kryesore: zona skeletore, zona e sipërme frytdhënëse dhe zona e mesme pa degëzime (boshe).
- Zona skeletore – përbën pjesën e poshtme të kurorës së pemës. Kjo zonë përbëhet nga 4-7 degë skeletore të cilat janë të radhitura në mënyrë spirale në udhëheqësin qendror. Dega e parë fillon nga lartësia 80 cm prej nivelit të tokës. Këto degë mund të qëndrojnë në pemë gjatë gjithë ciklit jetësor të pemës, varësisht nga gjendja shëndetësore dhe potenciali prodhues mund të bëhet ripërtëritja (zëvendësimi) i tyre. Këto degë skeletore e kanë edhe zonën e majës së rritjes së tyre e cila mirëmbahet përmes krasitjes me sistemin “klik”

Zona skeletore –

- Përbën pjesën e poshtme të kurorës së pemës.
- Kjo zonë përbëhet nga 4-7 degë skeletore të cilat janë të radhitura në mënyrë spirale në udhëheqësin qendror
- Dega e parë fillon nga lartësia 80 cm prej nivelit të tokës.
- Këto degë mund të qëndrojnë në pemë gjatë gjithë ciklit jetësor të pemës, varësisht nga gjendja shëndetësore dhe potenciali prodhues mund të bëhet ripërtëritja (zëvendësimi) i tyre
- Këto degë skeletore e kanë edhe zonën e majës së rritjes së tyre e cila mirëmbahet përmes krasitjes me sistemin “klik”




Fig .21. Zonat e sistemit balerinë

Zona e mesme (shtati i kurorës) –

- Ndodhet në mes të zonës skeletore dhe zonës së sipërme frytdhënëse.
- Kjo zonë ka një hapësirë rreth 40 cm ose dy palë gërshërë në mes të dy zonave në udhëheqësin qendror.
- Kjo zonë është boshe nuk ka fare degëime dhe shërben për ajrosje dhe ndriçim më të mirë të kurorës.




Fig .21. Zonat e sistemit balerinë

Zona e sipërme frytdhënëse –

- Përbën pjesën e sipërme të kurorës së pemës
- Kjo zonë përbëhet nga degë gjysmë skeletore dhe veshëze të cilat janë të radhitura gjithashtu në mënyrë spirale në udhëheqësin qendror
- Hapësira në mes degëve gjysmë skeletore duhet të jetë së paku 20 cm.
- Degët gjysmë skeletore mund të qëndrojnë maksimalisht në pemë 4 vjet, pastaj duhet të bëhet ripërtëritja (zëvendësimi) e tyre me degë të reja.
- Në këtë zonë ndodhet gjithashtu maja e rritjes së pemës ose udhëheqësit qendror e cila po ashtu mirëmbahet përmes krasitjes “klik





Fig .21. Zonat e sistemit balerinë

Punët pas mbjelljes së fidanëve.

- Pas mbjelljes së fidanëve bëhet krasitja e tyre. Krasitja fillon nga pjesa e poshtme duke larguar të gjitha degëzat deri në lartësi 80 cm.
- Pastaj bëhet rrallimi (largimi i degëzave të tepërta) në mënyrë që në fidanin e porsa mbjellë të ngelin 5 – 7 degëza të radhitura në mënyrë spirale përgjatë udhëheqësit qendror.
- Pastaj nëse fidani është i zhvilluar mirë (extra knip) mbi degëzimin e shtatë, 20 cm përgjatë udhëheqësit qendror largohen të gjitha degëzat.
- Ndërsa degëzat në pjesën e sipërme të fidanit të cilat janë më të shkurta mbesin mund të rrallohen varësisht prej pozicionit dhe dendësisë së tyre.
- Pas krasitjes bëhet lakimi i degëzave përmes lidhjes në telin e poshtëm të sistemit mbështetës i cili ndodhet 60 cm mbi nivelin e tokës.



A

B

C

Fig .22. Krasitja e fidanit "knip": A – para krasitjes, B– pas krasitjes dhe lidhjes, C– lidhja e deqëzave

Punët në formim të kurorës.

- Fidanët të cilët nuk janë të degëzuar mirë rekomandohet stimulimi (nxitja) e shpërthimit të sythave vegetativë.
- Kjo arrihet përmes gjysmë unazimit apo prerjes së lëvres mbi sythin të cilin dëshirojmë ta aktivizojmë.
- Gjithashtu edhe degëzat të cilat kanë rritje të fuqishme bëjmë lakimin me një kënd të ashpër.
- Pas vegetacionit të parë, gjatë krasitjes dimërore, udhëheqësi qendror pritet.
- Varësisht nga rritja e tij mund të pritet 40 cm mbi telin e sipërm i cili ndodhet 2 m mbi nivelin e tokës ose nëse udhëheqësi qendror ka rritje më të fuqishme pritet 20-30 cm nën majën e rritjes.



Fig .23.: A – gjysmë unazimi, B – lakimi i degëzave

Punët në formim të kurorës.

- Krasitja në pjesët e tjera të kurorës bëhet varësisht nga zhvillimi dhe pozicioni i degëzave ku mund të bëhet krasitja në cep të degëzimeve më të fuqishme mbi zonën skeletore si dhe mirëmbajtja e gjatësisë së degëve skeletore.
- Pas vegjetacionit të dytë, degëzimet në pjesën e sipërme të udhëheqësit qendror priten në sistemin “klik” ku degëza e sipërme pritet në 3-5 sytha, ndërsa dy degëzat e poshtme priten në cep.



Prerja e udhëheqësit qendror




Fig .24. Prerja e udhëheqësit qendror-reaksioni

Prerja e drejt

Prerja e gabuar




Fig .26. Kufizimi i rritjes së udhëheqësit qendror, prerja e drejtë "klik" dhe e gabuar

Duhet pasur kujdes gjatë mirëmbajtjes – kufizimit të rritjes së udhëheqësit qendror sepse gjatë krasitjes mund të stimulojmë rritjen vegetative.



Fig .27. A-prerja e drejt dhe reagimi i pemës, B-prerja e gabuar dhe reagimi i pemës




Fig .29. Dukja përfundimtare skematike e sistemit balerinë

Kur pema të hyjë në prodhim të plotë pamja e sajë përfundimtare duhet të jetë:

- Zona e poshtme skeletore - me 5 degë skeletore të veshura me degëza frytdhënëse, majat e rritjes mirëmbahen me krasitje “klik”
- Zona e mesme – pa degëza në distancë 40 cm ose dy palë gërshër në mes të dy zonave
- Zona e sipërme – duhet të ketë degë-za 1, 2, 3, 4 vjeçare të cilat duhet të jenë në distancë 15 – 20 cm nga njëra-tjetra të vendosura në formë spirale përgjatë udhëheqësit qendror. Degët 2,3,4 duhet të jenë të veshura me degëza frytdhënëse. Degët 4 vjeçare duhet të zëvendësohen pas vitit të katërt. Udhëheqësi qendror mirëmbahet me krasitje “klik”




Fig .29. Dukja përfundimtare skematike e sistemit balerinë


- Solaksi - është zhvilluar në Francë
- Si një sistem për kulturën e mollës dhe që nga ajo kohë është adaptuar në Francë dhe veqanërisht në Kil në kultivar të qershisë.
- Pema e qershisë rritet në nënshartesë me bujshmëri të ultë në Gisela 5, 6 apo Max
- Distanca në rend është 2-3m dhe 5m në mes rendeve.




Superfuseau

Taille longue



Pincements d'été




Solaxe



Solen


















Forma piramidale e kurorës





Kaquba e thepisur






Kultivari Stenly


Kurora	Distanca / m	Bimë /ha	Rendimenti /t/ha/			
			Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6
Kaquba e thepisur	4 x 1	2500	8.45	12.72	15.27	42.75
	4 x 1.25	200	8.08	10.12	15.18	42.32
	4 x 1.5	1667	7.12	11.05	12.84	34.15




Tatura



Cherry training systems in NC-140 Trial: The interaction between four canopy training systems – Kym Green Bush (KGB), Tall Spindle Axe (TSA), Super Slender Axe (SSA), and Upright Fruiting Offshoots (UFO) – and new rootstocks are being compared in this NC-140 trial. (Graphic credit: Greg Lang)




Tall Spindle Axe (TSA)




SSA

**Super Slender
Axe
(SSA)**



UFO

**Upright Fruiting Offshoots
(UFO)**



KGB

Kym Green Bush (KGB),

















Heqja e luleve te para dhe lozëve



Pastrimi dhe rrallimi i dredhëzës nga pjesët e vjetra

Krasitja e mjedres dy vjeçare



Ne rregull








Jo ne rregull

Paraqitje skematike e krasitjes së mjedrës dy vjeçare



Në kohën e vjeljes së lastarëve të vjetër, lastarët e rinj duhet të jenë të gjatë deri në katin e parë të telit



Krasitja e mjedres një vjeçare



Sistemi I kultivimit të manaferrës

Ekzistojnë dy sisteme për kultivimin e manaferrës:


- kaçubor – me distancë katrore kënddrejtë
- palmetë ose erashkë horizontale.



Krasitja e manaferrës

- në periudhën e vegjetacionit
- në fund të vegjetacionit

- mënjanimi i lastarëve që kanë dhënë fruta (menjëherë pas vjeljes),
- Shkurtimi i lastarëve për zëvendësim në gjatësi 1.8 – 2.0 m (deri në gjysmën e qershorit),
- shkurtimi i rritjeve anësore në gjatësi 6 – 7 gjethe (deri në gjysmën e shtatorit).



Krasitja pranverore, shkurtimi i lastarëve frutdhënës në lartësi 3 -4 sytha

Krasitja e boronices

- Krasitja e boronicës është një masë e rëndësishme.
- Gjatë vitit të parë deri në vitin e tretë, nuk kërkohet ndonjë krasitje e madhe me përjashtim të heqjes së degëzave të dëmtuara dhe atyre të zhvilluara dobët, atyre afër tokës dhe heqja e luleve me qëllim që të stimulohet zhvillimi i sistemit rrënjorë dhe rritja e drejtë e shkurrës.
- Në vitin e katër dhe gjatë prodhimit, një shkurre e rritur plotësisht duhet të ketë maksimalisht 12 këmbza me moshë 1-6 vjeçare.
- Duhet hequr degëzat e zhvilluara dobët qofshin frutore apo vegjetative si dhe dhe të gjitha këmbëzat më të vjetra se 6 vjeçare dhe atyre që tejkalojnë numrin 12. Këmbëzat 1-6 vjeçare janë më vitale dhe japin fruta më cilësore (Handley, 2008)
- Kultivarit Duke ka kurorë me te rrallë lastar njevjeçar me të zhvilluar dhe kërkon prerje te majave te lastarve per stimulim te degezimeve
- Kultivari Bluecrop ka karakteristikat gjenetike për formimin e numrit të madhë të këmbzave. Kështu që, në vitet e para, para se të hyjë në frutdhënje të plotë bima nuk duhet të ketë më shumë se 4-6 këmbza, ndërsa në prodhim të plotë nuk duhet ta kaloj numrin 12 dhe mosha e këmbzave duhet të jetë nga 1- 6 vjeçare.
- Kultivarit Legacy ka bujshmëri më të lartë të kurorës. Kërkon distanca më të mëdha bima prej bimës 1-1.5m, kërkon krasitje të rregullt për rënditje, përtritje dhe ajrosje të kurorës.





MIRËMBAJTJA E TOKËS NE PEMISHTE



Mirëmbajtja e tokës ne pemishte

Pas mbjelljes se pemëve toka ne pemishte duhet te mirëmbahet rregullisht ne mënyrë qe te rritet pjelloria e saje. Mirëmbajtja e tokës me se shpeshti behet ne keto mënyra :

- ▶ Punimi i vazhdueshëm i tokës ose ugar i zi
- ▶ Kultivimi i nen kulturave ne pemishte
- ▶ Punimi i tokës me mbjellje te përkohshme te bimëve për plehërim te gjelbër
- ▶ Kultivimi i barit natyral (lendinë) i kombinuar me plehra minerale.
- ▶ Kultivimi i barit te fisnikëruar ne mes te rendeve dhe mirëmbajtja e tokës ne rende
 - ▶ Mihja e tokës ne rendin e pemëve
 - ▶ Mulchirimi ose mbulimi i tokës me materiale te ndryshme(organike–inorganike)
 - ▶ Trajtimi i tokës ne mes te rendeve me herbicide
- ▶ Malqirimi
- ▶ Se cila mënyrë do te përdoret ne pemishte vendos fermeri duke i marre ne konsideratë faktorët ekologjik te regjionit ku kultivohen pemët.

Punimi i vazhdueshëm i tokës ose ugar i zi

Behet rregullisht punimi i tokës

- ▶ Perpresite: asgjasohen barojat në pemishte
 - ▶ Permirsohet struktura e tokës
 - ▶ Rregullohet raporti uja-ajer
 - ▶ Me mirë ruhet lageshtia e tokës
 - ▶ Pemet e zhvillojnë me shumë - thell sistemin rrenjor
 - ▶ Toka me mirë frymon
 - ▶ Me shpejtë dhe me mirë zhvillohet mikoriza e rrenjeve e cila ka funksion në zberthimit të materieve në format më të përshtatshme
- ▶ Kjo mënyrë ka përparsi vetëm nëse bëhet vazhdimisht pleherimi i pemishtës me plehera organike të nevojshme në të kundërtën kemi pasoja – struktura e tokës është më e dobët, ngjeshja më e madhe, sistemi rrenjor ngulfatet etj.
- ▶ Qasja në pemishte të kufizuar (zbatimi i masave agropomoteknike)
 - ▶ Spërkatja
 - ▶ Krasitja
 - ▶ Vjelja

Punimi i vazhdueshëm i tokës ose ugar i zi



Punimi i tokës me mbjellje të përkohshme të bimëve për plehërim të gjelbër

- Në përmishtë të kësaj mungojnë plehurat organike , sepse bashku me pununimin e tokës bëhet mbjellja e bimëve për plehërim të gjelbër-sideracion i cili kur të lavrohet krijon masë të madhe organike.
- Mbjetllja e bimëve për plehërim bëhet në ato vende ku ka të reshura të mjaftueshme, të cilat janë të radhitura mirë.
- Si kultura për plehërim të gjelbër preferohen : lupini, bezelja e bagetive, koleza, bizele + thekra.



Mirmbajtja e pemishtes me barit natyral (lendinë)

- ▶ Eshte mënyra më e keqe e mirmbajtjes se pemishtes
- ▶ Kjo mënyre aplikohet te pemishtet te cilat jane lene pas dore.
- ▶ Bari hargjon sasi te madhe te ujit sidomos ne kohen e lulezimit te pemeve dhe rritjes intensive.
- ▶ Pemët ngecin ne rritje, frutat i kane me te vegjel, diferencimi - fomimi i sythave frutor eshte me i vogel etj.
- ▶ Aplikohet vetem te pemishtet ekstenzive dhe gjysem intensive duke aplikuat plehtimin e rregullte.



Kultivimi i barit ne mes te rendeve

- Toka ne mes te rendeve mbillet me përzierje te bari te fisnikëruar dhe tërfilit ne vendet ku ka te reshura te mjaftueshme. Bari siguron mase te gjelbër ndërsa tërfili pasuron token me azot.
- Bari vazhdimisht kositet kur te arrij lartësinë 15cm dhe lihet ne vend qe te denatyrohet.
- Brërat që përdoren më tepër: familja Graminaceae (Lolium perrene 30 kg/ha, Lolium italicum 20 kg/ha, Poa trivialis, 10-12 kg/ha, Dactylis glomerata, 25-30 kg/ha etj.) Familja Fabaceae (trifili i kuq dhe trifili i bardhë 10-12 kg/ha).
- Mirëmbajtja e tokës brenda rendit mund të bëhet në forma të ndryshme:
 - Kultivimi (punimi) i tokës ne rendin e pemëve
 - Trajtimi i tokës ne mes te rendeve me herbicide
 - Malqerimi ose mbulimi i tokës me materiale te ndryshme (organike–inorganike)

• **Përparësitë:**

- Qasja në pemishte edhe në kushte te papërshtatshme atmosferike
- Zvogëlohet ngjeshja e tokës
- Në rast se ka te reshura te shumta sistemi rrënjor nuk pëson dëme se bari e thith ujin e tepert.
- E mbron token nga erozioni
- Bari që kositet rregullisht mund të shërbej si malq
- Ruajtja e biodiversitetit
- Përmirësimi i vetive të tokës - struktura, përshkueshmëria, poroziteti, regjimi ujë-ajër, rrit përmbajtjen e humusit dhe pjellorinë;
- Përmirësimi i aktivitetit mikrobiologjik dhe të faunës në tokë;
- Ulja e temperaturës së tokës në muajt e verës;
- Lagështia relative në ajër rritet, dhe avullimi zvogëlohet;

• **Dobësitë :**

- Kostoja e mbjelljes së barit
- Kërkesat më të larta për ujë
- Në vitet e para, konsumohen më shumë lëndë ushqyese.

Kultivimi (punimi) i tokës në rendin e pemëve

- Kjo është një nga mënyrat më të përdorura për të mbajtur sipërfaqen në rregull.
- Punimi i tokës bëhet me dorë ose me mekanizim bujqësor sikur të ashtuquajturat kultivues anësor.
- Kultivimi nuk duhet të jetë më i thellë se 5-6 cm, gjegjësisht të kryhet vetëm për shkatërrimin e barërave të këqija dhe shkatërrimin e hapjeve kapilare, në mënyrë që të zvogëlohet humbja e lagështisë së tokës.
- Numri i kultivimeve varet nga prezenca e barërave të këqija. Për ruajtje më të madhe të lagështisë, përpunimi duhet të bëhet më shpesh, dhe i detyrueshëm pas çdo shiu të fortë.
- Kultivimi me dorë i kësaj zone është më i dobishëm për pemët frutore, por është mënyra më e shtrenjtë në krahasim me mënyrat e tjera të mirëmbajtjes së tokës. Rekomandohet të përdoret vetëm në rastet e plantacioneve të reja ku nuk mund të aplikohen metoda të tjera të mirëmbajtjes.
- Përdorimi i kultivuesve anësor për të kultivuar sipërfaqen në rresht tani është një praktikë e zakonshme. Për këtë qëllim, makina të posaqme (freza, pjator) ku një organi punës i makinës është i vendosur jashtë dimensioneve të traktorit, i cili kultivon tokën në rresht. Përveç organit të punës, këto makina kanë edhe një levë anësore e cila kur preket dhe shtypet nga trupi i pemës, përmes një sensori e kthen organin e punës në hapësirën midis rreshtave.





Përdorimi i herbicideve:

- Herbicidet janë kimikate që synojnë të shkatërrojnë barërat e këqija, duke parandaluar shfrytëzimin e tyre të lagështisë dhe lëndëve ushqyese nga toka.
- Në pemëtore, praktika më e zakonshme për të mbajtur sipërfaqen në rregull është përdorimi i herbicideve sintetike që shkatërrojnë florën e padëshiruar
- Zgjedhja e herbicideve varet nga periudha e vitit, lloji i barërave të këqija, lloji i frutave, mosha e plantacionit etj.
- Ky model i mirëmbajtjes së sipërfaqes është mjaft efektiv dhe ofron kushte të favorshme për rritjen e pemëve dhe lëvizjen e mekanizimit në plantacione.
- Herbicidet janë efektive, të lehta për t'u aplikuar, relativisht të lira dhe sigurojnë rendiment të lartë të pemëve.
- Sistemi rrënjor rritet më mirë në pemët frutore ku hapësira në rresht trajtohet me herbicide në krahasim me kultivimin ose në sipërfaqen e papunuar.

- Dobësitë :

- Përdorimi i zgjatur i herbicideve përkeqëson strukturën e tokës, zvogëlon përmbajtjen e humusit, ul reaksionin e pH, rrit përmbajtjen e manganit të lirë në nivele toksike;
- Zhvillimi i rrënjëve në shtresat sipërfaqësore mundëson kontaktin me herbicidet, veçanërisht me tokën, të cilat nëpërmjet rrënjëve vijnë te fryti;
- Numri i vogël i herbicideve të regjistruara për përdorim në pemëtore krijon problem në praktikë;
- Përdorimi i tepërt i disa herbicideve çon në fitotoksicitet, prani të mbetjeve në mjedis, pemë dhe fruta dhe shfaqjen e biotipeve rezistente të barërave të këqija;
- Fitotoksiciteti i herbicideve ka një ndikim negativ në rizadosferën e pemëve frutore dhe numrin e mikroorganizmave të tokës, gjë që redukton disponueshmërinë dhe marrjen e makro dhe mikroelementeve ushqyese nga frutat;

- Sipas mënyrës së veprimit, herbicidet ndahen në tre grupe: tokësore ose parandaluese, kontaktuese ose gjethore dhe translokuese ose sistemike
 - Herbicidet e tokës aplikohen përmes tokës. Këto herbicide nuk lejojnë që farat të mbijnë ose rizomat të dalin në sipërfaqen e tokës.
 - Ato aplikohen para se të mbijnë barërat e këqija, kurse plantacionet aplikohen në fillim të pranverës, para fillimit të vegjetacionit.
 - Para aplikimit të tyre, toka duhet të jetë e kultivuar mirë dhe e niveluar.
 - Mekanizmi i veprimit është që gjatë mbirjes barërat e këqija bien në kontakt me substancën aktive, thithin një pjesë të saj dhe vdesin. Disa barëra të këqija janë të ndjeshme edhe pas mbirjes, por nuk duhet të jenë më të larta se 1-2 gjethe.
 - Nëse ka më shumë barërat e këqija, atëherë ato mund të kombinohen me disa herbicide kontakti.

- Herbicidet e kontaktit ose gjetheve shkatërrojnë gjethet dhe pjesët e tjera të gjelbra të barërave të këqija.
- Gjatë aplikimit të tyre ekziston rrezik i madh që të aplikohen në pjesët e gjelbra të pemëve, por edhe në trupin e pemëve të reja.
- Aplikohen pas shfaqjes dhe rritjes së barërave të këqija nga 15 deri në 20 cm.
- Ato janë veçanërisht efektive kundër barojave njëvjeçare.
- Ato aplikohen në periudhën prill-maj kurka numër më të madh të barërave të këqija.
- Pas trajtimit, barërat e këqija asgjësohen dhe në pak ditë thahen dhe shtrohen, gjë që bën malq organik që mbulon sipërfaqen në rresht.
- Këto herbicide nuk janë shumë efikase në kontrollin e rizomës së barërave të këqija, sepse shkatërrojnë vetëm masën mbitokësore dhe pas një kohe përmes rizomave, barërat e këqija rigjenerohen përsëri.

- Herbicidet sistematike ose translokuese përdoren për të shkatërruar barërat e këqija gjatë sezonit të rritjes.
- Pas trajtimit, herbicidet thithen nga pjesët e gjelbra të bimës, dhe më vonë përmes sistemit të përcjelljes ato zhvendosen në sistemin rrënjor.
- Në këtë mënyrë shkatërrohen të gjitha pjesët e bimës. Ata quhen gjithashtu herbicide totale sepse shkatërrojnë shumicën e specieve bimore, madje edhe bimët që rrisim në plantacion.
- Ata shkatërrojnë shumicën e barërave të këqija që do t'i thithin ato në sasi të mjaftueshme.
- Përdorimi i tyre bëhet kur bimët arrijnë një lartësi prej rreth 20 cm, kur barërat e këqija kanë një fuqi më të madhe për të thithur lëndën aktive.
- Nga ky grup preparatet më të përdorura bazohen në substancën aktive Glifosat (glyphosate). Efekti i trajtimit shihet në dhjetë ditë, dhe barërat e këqija shkatërrohen plotësisht në rreth një muaj.
- Për shkak të rrezikut të përthithjes nga masa gjethore e pemëve të kultivuara, lastarët, dhe degëzat në lartësinë e trupit të pemës duhet të hiqen përpara aplikimit.



Trajtimi i tokës ne pemishte me herbicide

Malciritimi ose mbulimi i tokës


- ▶ Malciritimi është mbulimi i tokës me materje të ndryshme organike të cilat me vone kalben dhe pasurojnë tokën me humus (kashta, tallë, sara, bari i kositur).
- ▶ Në panverë pas punimit të tokës bëhet mbulimi i tokës me trashësi të malqit 10-15 cm.
- ▶ Materiali për mbulim të rendit mund të përdoret : folia e zeze , lesh byk sharre, ashklla druri, bari i kositur, kashtë, pamhuk siri eti

Përparësitë:

- ▶ rritet aktiviteti i mikroorganizmave në malc
- ▶ nuk e lejon avullimin e ujit nga toka (ruan lagështinë)
- ▶ zvogëlon erozionin
- ▶ përmirëson strukturën e tokës
- ▶ rregullohet regjimi ngrohës i tokës dhe e ruan sistemin rrënjor nga ngricat.

▶ Dobësitë:

- egziston rrezik nga zjaret
- në malq mund të dimrojnë dhe të shumohen dëmtuesit - bregtesit







Kultivimi i nen kulturave ne pemishte

- ▶ Nenkulturat e vështirosjen punën e makinave ne pemishte dhe marrjen e masave te rregullta agroteknike e sidomos trajtimit ndaj sëmundjeve dhe dëmtuesve pasi qe nuk mund te përdoren preparatet e caktuara per te mos i ndotur nen kulturat...
- ▶ Nënkulturat shpenzojnë sasi të konsiderueshme të ujit dhe ujit, kështu që e dobësojnë zhvillimin e
- ▶ Bizelja , fasulja etj e pasurojnë token me azot por toka duhet te plehërohet ,ujitet e punohet vazhdimisht.



19/06/2008